



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETITIT
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ .07.2026

Lënda: Përgjigje kërkesës së paraqitur nga znj. E.S.
Adresa: Rruga: “N.Gj.”

SHKODËR

E nderuar znj. S.!

Në përgjigje të kërkesës tuaj drejtuar Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (Autoriteti), me tonën nr. 1607 prot., datë 20.07.2026, me anë të së cilës kërkonti *“informacion me shkrim dhe kopje të njësisë me origjinalin të autoritetit të kohës (Komiteti Ekzekutiv Durrës) për transferimin e gjendjes civile të familjes V.S. nga, të urdhrit të autoritetit të kohës për nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit të K.E. Durrës për transferimin fizik të familjes nga banesa, urdhrit të autoritetit të kohës për nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit të K.E. Luzi Vogël në zbatim të urdhrit të K.E. Durrës për transferimin fizik të familjes, ”*, Ju informojmë se :

Objekti i kërkesës tuaj për informacion dhe dokumentacion i nënshtrohet ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” i ndryshuar, dhe jo ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, pasi informacioni i kërkuar në kuptim të pikës 2 të nenit 2 të ligjit nr 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, nuk konsiderohet informacion publik por informacion për dokumentacion arkivor, prandaj procedura për mënyrën se si të aksesohet, shqyrtohet dhe vendoset në dispozicion informacioni, rregullohet nga ligji nr. 45/2015, sipas afateve procedurale të Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit.

Sa më sipër, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, ligjit nr. 45/2015, kërkesa juaj, për vënie në dispozicion të dokumentacionit arkivor sipas objektit, është adresuar dhe përcjellë për kompetencë pranë strukturave përkatëse të institucionit që sipas ligjit nr. 45/2015, trajtojnë kërkesa me të njëjtin objekt si kërkesa juaj.

Në çdo rast, për ecurinë e praktikës, paraqitjen ose vënien në dispozicion dhe plotësimin e të dhënave shtesë nëse gjykohet e nevojshme prej tyre dhe deri në përfundim të procesit, do të njoftoheni nga strukturat përkatëse të institucionit me shkresë në adresën e paraqitur në kërkesën drejtuar Autoritetit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

**Kordinatori i të drejtës për informim pranë Autoritetit
L. Cocoli**

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Sofi Noti